V E N D I M

Nr. 788, datë 17.12.1998

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 537, DATË 26.9.1994 "PËR SHTESË MBI PAGËN PËR KUALIFIKIM TË MËSUESVE DHE SHTESË PËR VEPRIMTARI TË INSPEKTORËVE TË ARSIMIT"

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 537, datë 26.9.1994, pika 3 të ndryshohet si vijon:

"Inspektorëve të drejtorive arsimore në rrethe, drejtuesve të tyre, inspektorëve e drejtuesve të tyre në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës u bëhet shtesë mbi pagë 15 për qind, për vështirësi shërbimi.".

2. Efektet financiare, sipas këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 1998, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 29.7.1997.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko